



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 tetor 2016
Nr. ref.:RK991/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI83/16

Parashtrues

Iliria dhe APIKO

**Kërkesë për vlerësimin e “ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë” së
Aktgjykimit KI132/15 të
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
të 20 majit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Iliria dhe APIKO, dy ndërmarrje shoqërore (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga z. Teki Bokshi, avokat në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë *"ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë"* e Aktgjykimit KI132/15 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të 20 majit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesve të kërkesës drejtuar Gjykatës që të *"anulohet"* dhe *"vihet jashtë fuqie"* Aktgjykimi i lartpërmendur i saj, i cili, siç pretendojnë ata, është *"i paligjshëm dhe jokushtetues"*.
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Kushtetuese ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 1 [Përkufizimi i Shtetit]; nenin 2 [Sovraniteti]; nenin 3 [Barazia para Ligjit]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); të drejtat e tyre të garantuara me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe nenin 2 [E drejta e apelit në çështjet penale] të Protokollit 7 të KEDNJ-së; e drejta e tyre e garantuar me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: UDHR); si dhe e drejta e tyre e garantuar me nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejme: KNDKP).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 21 maj 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë përmes shërbimeve postare. Ata deklaruan se do të rezervojnë të drejtën që ta plotësojnë kërkesën e tyre brenda një afati të arsyeshëm.
7. Më 25 maj 2016, Gjykata e pranoi kërkesën në zyrat e veta.
8. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
9. Më 26 maj 2016, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë autorizimin për Iliria dhe APIKO brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve.
10. Më 27 maj 2016 dhe 1 qershor 2016, parashtruesit e kërkesës dorëzuan dokumente shtesë.

11. Më 15 qershor 2016, parashtuesit e kërkesës dorëzuan autorizimin e kërkuar si dhe plotësuan kërkesën e tyre me informata shtesë.
12. Më 11 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan si anëtar të Kolegjit shqyrtues me gjyqtaren Snezhana Botusharova, e cila mori përsipër rolin e gjyqtarës kryesuese në Kolegjin shqyrtues.
13. Më 15 korrik 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 3 nëntor 2015, Manastiri i Deçanit parashtroi kërkesën [KI132/15] në Gjykatë, duke kërkuar *“vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit”*. Manastiri i Deçanit, po ashtu, kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme deri sa të merret vendimi për meritat e kërkesës.
15. Më 12 nëntor 2015, Gjykata (Vendimi nr. Ref. VMP865/15) lejoi masën e përkohshme të kërkuar. Ai vendim ishte publikuar më 3 dhjetor 2015 dhe ishte në fuqi deri më 29 shkurt 2016.
16. Më 10 shkurt 2016, Gjykata (Vendimi nr. ref. VMP889/16) e vazhdoi masën e përkohshme. Ai vendim ishte publikuar më 12 shkurt 2016 dhe ishte në fuqi deri më 31 maj 2016.
17. Më 20 maj 2016, Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56 (a) të Rregullores së punës, nxori Aktgjykimin KI132/15, me të cilin vendosi për pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës të dorëzuar nga Manastiri i Deçanit. Gjykata Kushtetuese, në pjesën operative të Aktgjykimit, vendosi:

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË që nuk është e nevojshme të ekzaminojë nëse ka pasur shkelje të neneve 24, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

IV. TË KONSTATOJË që dy vendimet e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, janë të pavlefshme, dhe se dy vendimet e Kolegjit të Specializuar për Pronësinë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 27 dhjetorit 2012, nr. SCC-08-0226 dhe nr.

SCC-08-0227, janë përfundimtare të detyrueshme dhe, si të tilla, janë, res judicata;

V. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin e Gjykatës janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 1, 2, 3, 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës; nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe nenin 2 të Protokollit 7 të KEDNJ-së; nenin 10 të DUDNJ-së; si dhe nenin 14 të KNDKP.
19. Në të vërtetë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, para vendosjes “ka qenë e domosdoshme që të caktohet seanca dëgjimore (...) duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, në aspektin faktik dhe juridik, involvimin e shumë subjekteve, interesimin e madh të opinionit publik dhe reperkusionet e vlerësohej që mundë të krijoj vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe pasojat e vendimit”. Ata konsiderojnë se pamundësimi i mbajtjes së “një seance dëgjimore, publike e transparente, këtë gjykim [KI132/15], e bëjnë [...] jo korrekt dhe jo të drejtë”.
20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “përkundër pritjeve të subjekteve [Iliria dhe APIKO], Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit të atakuar me këtë kërkesë, nuk ka vlerësuar të drejtën themelore në pronë dhe ka legjitimuar një marrëveshje joligjore, jo kushtetuese, përfundimisht jo etike të lidhur mes UNMIK-ut dhe manastirit të Deçanit”.
21. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata, si në vijim:

“Që Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI132/15 të datës 20 maj 2016, në çështjen e iniciuar nga Manastiri i Deçanit, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015 Ac.-1-13-0008 dhe Ac.-I-0009 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështjet që lidhen me agjencinë kosovare të privatizimit, të revokohet, të vihet jashtë fuqie, si i paligjshëm dhe jokushtetues,
të rihapet shqyrtimi gjyqësor, në mënyrë që të përsëritet procedura,
të caktohet seanca dëgjimore, ku do të ftohen të gjitha palët dhe të mbahet gjykim transparent, publik,
të caktohen amicus curiae, në mënyrë që të ndihmojë palët dhe Gjykatën,
të shqyrtohen ankesat dhe kundërshtimet e subjekteve si pronarë të pronave,

të konstatohet se E.T. ka bërë shkelje ligjore kur ka lidhur marrëveshje, ujdë apo kur ka përfaqësuar para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pasi që përfaqësues në atë Dhomë mund të paraqitet vetëm personi që ka licencë avokati, që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të lejoj Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Deçan të procedoj normalisht, që ajo Gjykatë të kryej funksionin e saj ligjor dhe kushtetues, duke marrë parasysh se edhe Gjykata Themelore në Pejë, dega në Deçan, është gjykatë brenda sistemit të Republikës së Kosovës.”

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Gjykata fillimisht i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e parashtruan kërkesën e tyre në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, në mënyrë që të kontestojnë *“ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë”* e Aktgjykimit të kontestuar. Ata pretendojnë se Aktgjykimi është *“i paligjshëm dhe jokushtetues”* dhe se, si i tillë, ka shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të përmendura më lart. Si rezultat, ata kërkojnë nga Gjykata që të *“revokohet”* dhe *“të vihet jashtë fuqie”* Aktgjykimi i saj.

25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 113.7 është i vendosur në Kapitullin VIII të Kushtetutës i cili mban titullin *“Gjykata Kushtetuese”*. Përveç kësaj, neni 113.7 i Kushtetutës është titulluar *“Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara”*. Vendosja dhe titujt e përmendur janë të rëndësishëm për të qenë të vetëdijshëm për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe për palët të cilat janë të autorizuar që të referojnë çështje kushtetuese në Gjykatë.

26. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se dispozita kushtetuese e paraparë me nenin 113.7 i referohet palëve të autorizuar që mund të ngrenë shkeljet që pretendohet të jenë kryer nga vendimet e autoriteteve publike, përveç atyre të Gjykatës Kushtetuese.

27. Gjykata konsideron se një përfundim i tillë rrjedh vetvetiu sapo të lexohet, dhe duhet të lexohet, në lidhje me paragrafët 1 të neneve 112 [Parimet e Përgjithshme] dhe 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës. Këto dispozita kushtetuese përcaktojnë:

Neni 112 (1)

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Neni 116 (1)

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

28. Gjykata gjithashtu vëren se nuk ekziston asnjë dispozitë në Kushtetutë që u siguron individëve apo personave juridik të drejtën që të kontestojnë “ligjshmërinë ose kushtetutshmërinë” e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, qofshin ato aktgjykime, aktvendime apo urdhëra të tjerë. Përkundrazi, ekzistojnë dispozita, siç janë ato të neneve 112.1 dhe 116.1, të cilat ndalojnë çdo veprim ligjor kundër vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Logjika prapa neneve 112.1 dhe 116.1 të Kushtetutës është që të bëhet e qartë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare, të detyrueshme dhe përbëjnë çështje *res judicata*. Si të tilla, ato nuk mund të kontestohen nga askush për asnjë arsye.
29. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se vendimet e saj mund të korrigjohen vetëm për sa i përket gabimeve teknike dhe numerike. Një mundësi e tillë është paraparë në rregullin 61 [Përmirësimi i aktgjykimeve dhe vendimeve] të Rregullores së punës. Ky rregull parasheh:
- (1) *Gjykata, ex officio, ose pas kërkesës nga pala, e cila bëhet brenda dy javësh nga dërgimi i aktgjykimit apo i vendimit, mund ta korrigjojë ndonjë gabim teknik ose numerik që është bërë në aktgjykim ose në vendim. [...].*
30. Gjykata rikujton se parashtruesit kërkojnë që Gjykata ta “revokojë” dhe ta “vë jashtë fuqie” Aktgjykimin e saj (KI132/15, të 20 majit 2016). Një veprim i tillë ligjor nuk lejohet apo autorizohet në asnjë mënyrë me ndonjë dispozitë të Kushtetutës, të Ligjit ose të Rregullores së punës. Gjykata Kushtetuese nuk mund të rishqyrtojë, të anulojë, të rikonsiderojë apo shfuqizojë aktgjykimin (et) e saj, vendimin (et) ose urdhrin (at) e saj. Ajo thjesht mund të përmirësojë një gabim teknik apo një gabim numerik, e që nuk është ajo çfarë parashtruesit po kërkojnë përmes kësaj kërke.
31. Gjykata po ashtu rikujton se ajo është marrë me kërkesa të ngjashme, ku parashtrues tjerë kanë kërkuar vlerësim të kushtetutshmërisë të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, me të cilën ata ishin të pakënaqur. Në të gjitha rastet e tilla, Gjykata ka arsyetuar se vendimet e saj janë përfundimtare dhe detyruese, si të tilla ato janë *res judicata*, dhe kështu nuk mund të jenë objekt i ndonjë vlerësimi. (Shih rastet KI228/13, KIO4/14, KI11/14, KI13/14: parashtrues *Lulzim Ramaj* dhe *Shahe Ramaj* në rastin KI228/13 dhe *Lulzim Ramaj* në rastet KIO4/14, KI11/14, KI13/14, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2014; KI224/13-Parashtrues *Mustafë Osmani*; Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 2 qershorit 2014; KI221/13 - parashtrues *Shaqir Përvetica*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2014).

32. Për më tepër, Gjykata i deklaroi ato kërkesa të papranueshme, sepse nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
33. Si në rastet e mëparshme, Gjykata në vazhdimësi i referohet rregullit 36 (3) (e) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

(e) kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën [...].

34. Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta (at) në të cilat thirret parashtruesi (t) duhet të garantohej me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
35. Siç u pa më lart, Kushtetuta nuk parasheh të drejtën për të kontestuar “*ligjshmërinë ose kushtetutshmërinë*” e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, kërkesa e parashtruesve, përfshirë ankesat dhe kërkesat që përmbahen aty, nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Si rrjedhojë, Gjykata konkludon se kërkesat e përfshira në kërkesën e parashtruesve bien jashtë juridiksionit material të Gjykatës, d.m.th nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
36. Përveç kësaj, Gjykata thekson se një nga parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike është parimi i sigurisë ligjore. Kjo vlen sidomos për sa i takon vendimeve gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë, qoftë person fizik apo person juridik, nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin, revokimin, rikonsiderimin apo shfuqizimin e një vendimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm, thjesht për qëllim të fitimit të një rishikimi dhe rishqyrtimi të freskët të rastit (Shih: *mutatis mutandis*, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, nr. 48553/99, § 72, GJEDNJ 2002-VII, si dhe *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, § 52, GJEDNJ 2003-IX).
37. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se rishikimi, revokimi, rishqyrtimi ose shfuqizimi i një vendimi përfundimtar dhe detyrues do të çonte në një pasiguri të përgjithshme juridike, që do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të sundimit të ligjit. Me fjalë të tjera, kthimi i vendimeve të formës së prerë do të rezultonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë ligjore e cila do ta bënte rendin juridik krejtësisht joefektiv. Si pasojë, besimi i publikut në sistemin gjyqësor dhe në vetë sundimin e ligjit do të zvogëlohej dukshëm.
38. Në fund, Gjykata vlerëson se të gjitha kërkesat e tjera të përfshira në petitumin përfundimtar të parashtruesve, gjithashtu, duhet të refuzohen si të pabazuara. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nuk është e obliguar t'i përgjigjet çdo kërkesë të parashtruesve kur një kërkesë e konsideron si të papranueshme në baza procedurale, sikurse në rastin e tanishëm. Megjithatë, Gjykata do të shpjegojë shkurtimisht në 5 (pesë) paragrafët e mëposhtëm arsyen pse të gjitha kërkesat e tjera që gjenden në petitumin e parashtruesve duhet të refuzohen si të pabazuara.

39. Gjkata rikujton se parashtruesit kishin kërkuar që të urdhërohet “rihapje të procedurës së rregullt gjyqësore” dhe “të lejohet Gjykata Themelore në Pejë të procedoj normalisht”. Gjykata i referohet arsyetimit të saj të gjerë në aktgjykimin e saj të kontestuar. Prandaj, Gjykata e konsideron të panevojshme që të përsëritë apo kopjojë konkluzionet e dhëna aty, pasi që ajo veçse ka vendosur se cilat vendime ishin për t’u shpallur të pavlefshme dhe cilat ishin për t’u konsideruar si *res judicata*.
40. Parashtruesit gjithashtu kërkuar që të “caktohet një seancë dëgjimore” dhe “të caktohen parashtresat *amicus curiae*”. Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 24 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, nuk është e detyruar të mbajë seancë dëgjimore në qoftë se nuk e konsideron të nevojshme për të vendosë për meritat e një rasti. I njëjti parim vlen edhe për parashtresat *amicus curiae*, në pajtim me rregullin 53 të Rregullores së punës. Të dyja këto mundësi të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës janë mjete që janë të dizajnuara për ta bërë më të lehtë vendimmarrjen brenda Gjykatës. Megjithatë, është tërësisht në diskrecionin e Gjykatës, nëse e konsideron të nevojshme përdorimin e tyre apo jo në një rast të veçantë. Në të vërtetë, metoda kryesore e punës së Gjykatës është që të vendosë në bazë të informatave dhe dokumenteve që gjenden në shkresat e lëndës.
41. Parashtruesit kishin kërkuar më tej, që të “shqyrtohen ankesat dhe kundërshtimet e subjekteve nga Iliria dhe APIKO”. Gjykata vëren se parashtruesve u ishte dhënë mundësia që të komentojnë lidhur me kërkesën KI132/15, ku edhe ishte marrë aktgjykimi i kontestuar. Megjithatë, ata dorëzuan komentet e tyre 3 (tre) muaj pas afatit të caktuar nga Gjykata. E nga ana tjetër, parashtruesit asnjëherë nuk kishin kërkuar një zgjatje të mundshme të afatit. Për këtë arsye, Gjykata nuk i kishte marrë ato parasysht.
42. Së fundi, parashtruesit kërkuar nga Gjykata, “që të konstatojnë se E.T. kishte bërë shkelje ligjore”. Gjykata thekson se nuk është në juridiksionin e saj që të konkludojë se një person i caktuar ka bërë apo jo ndonjë shkelje ligjore. Prandaj, një kërkesë e tillë është jashtë çështjeve që mund t’i referohen Gjykatës në funksion të kompetencave të saj të përcaktuara me Kushtetutë.
43. Përfundimisht, Gjykata thekson se të gjitha kërkesat e lartpërmendura të parashtruesve bien jashtë fushëveprimit të kërkesave që mund të dorëzohen sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Sipas atij neni, individët janë të autorizuar “të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë”, e cila nuk është ajo që bënë parashtruesit me kërkesat e tyre plotësuese të bashkëngjitura në petitumin tyre përfundimtar. Rrjedhimisht, siç ishte shpjeguar më lart, Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar një çështje përtej kufijve të përcaktuar nga vetë Kushtetuta.
44. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se, në pajtim me nenet 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën dhe prandaj është e papranueshme.

45. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës, dhe rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, më 15 korrik 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi